Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Integral shpk" të datës 02.11.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor-Ritender me nr. të prokurimit 616-26-4184-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

# V E N D I M

I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Integral shpk" të datës 02.11.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor-Ritender me nr. të prokurimit 616-26-4184-5-2-1.

II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "Integral shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 02.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor-Ritender me nr. të prokurimit 616-26-4184-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.


Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Me datë: 30.09.2026 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eleminuar.
Ne si OE nuk pajtohemi me vleresimin dhe vendimin e AK-se për **"Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor-Ritender"**, sepse konsiderojme se AK na ka eleminuar pa te drejte duke qene se jemi OE me i pergjegjshem ne kete procedur te prokurimit me çmimin më të ulët.
Pra me qenese jemi eleminuar pa te drejte, pas vendimit te AK-se kemi verejtur se arsyet per eleminim te potencuara nga AK jane pa baze ligjore gjë që të cilat arsyes janë krejtësisht të natyrës teknike të cilat nuk ndikojn në përmbajtjen e dokumentacionit të ofruar nga ne si OE dhe të cilat qartesisht jane te pasqyruara ne dokumentet e paraqitura nga ne per secilin anetar te stafit te cilet jane pjese e listes se dorezuar nga ana jone, prandaj AK parase te na eleminonte per arsyet e cekura ne vendim do te duhet te kerkonte sqarime shtese ne menyre qe vlersimin e tendereve ta beje ne perputhje te plote me legjistacionin per prokurim publik.
Kjo bazohet ne faktin se, neni 72 i LPP-se percakton qarte veprimet qe duhet ti ndermar AK gjate fazes se vleresimit dhe te cilat kane mund te sqarohen lehtesisht nga ana jone me sqarimin e tendereve, gjithnje duke pas parasysh qellimin e dhe parimet e Ligjit per Prokurim Publik.

Sa i perket arsyeve per eleminimin nga AK , ne si OE ankues e kundershtojm vendimin e AK-se per eleminimin tone me argumentet dhe faktet të cilat po i paraqesim si me poshtë:

Sa i perket punëtorve fizik, pretendimi se me mungojn punetoret fizik dhe se i kam vetem 6 punetor fizik nuk qendron, per arsye se ne i kemi mbi 30 punetor gje qe eshte e vertetuar edhe me lajmerimin e tyre ne ATK. Punetoret e kompanise Integral Shpk, ne veqanti shoferat dhe manipuluesit e makinerise se rende realizojn edhe pune fizike, keshtuqe pretendimi i AK per eliminimin tone nuk qendron. Kjo padrejtesi behet edhe me e madhe kur rezulton se edhe vete kompania qe eshte shpallur fituese "Flamuri V" nuk i ploteson kushtet sipas kritereve te tenderit qe kerkohen 13 punetor fizik, ndersa kjo kompani ka vetem 10 punetor fizik.

Poashtu, ju njoftojm se gjate analizimit te dokumentacionit te kompanise fituese "Flamuri V Shpk" kemi konstatuar se i mungojn edhe dokumentacionet si ne vijim:

- Mungon Certifikata Fiskale e kompanise.
- I ka vetem 10 punëtor fizik, ndersa sipas DT kerkohen 13 punetor fizik,
- Te stafi Bachelor i Ndertimtarise, fleta e pare e CV-se nuk eshte e nenshkruar gje qe eshte ne kundershtim me kriterete e DT.
- Marrveshjeve per furnizim me beton dhe asfallt, ju mungojn dokumentet e biznesit, gje qe eshte ne kundershtim me DT.


Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Komisioni i Vlerësimit, pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertës suaj, ka konstatuar se oferta nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.**

**Për rrjedhojë, oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, pasi nuk keni dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, për arsyet e paraqitura më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: pika 5. Operatori ekonomik duhet të i ketë min. 13 punëtorë fizik për kryerjen e punimeve; 5 Punëtorë të jenë të certifikuar për siguri dhe mbrojtje në punë; ju si *OE për këtë pikë ka dorëzuar listën e stafit ku Komisioni i Vlerësimit pas shqyrtimit dhe analizimit konstaton se nuk ka arritur të dëshmojë për këtë pikë 13 punëtore, ku me ofertën tuaj keni paraqitur vetëm 6 punëtorë fizikë.***

Fillimisht duhet cekur se ky aktivitet i prokurimit është në rivlerësim. Në vlerësimin e parë, parashtruesi ishte eliminuar po ashtu si OE i papërgjegjshëm. Mirëpo asnjëherë nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim edhe nuk e ka kundërshtuar eliminimin e tij, përkatësisht është pajtuar me eliminimin e tij në vlerësimin e parë. Rrjedhimisht në këtë fazë të rivlerësimit, parashtruesi nuk mund të konsiderohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Tutje, sa i përket kundërshtimit të arsyeve eliminuese, parashtruesi parimisht nuk i kundërshton arsyet eliminuese por vetëm konsideron se është dashur të kërkohen sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP. Kjo nuk qëndron sepse LPP e përcakton saktë situatën kur mund të kur nuk mund të kërkohen sqarime shtesë. Përndryshe, gjatë vlerësimit të pretendimit ankimore dhe shqyrtimit të ofertës së parashtruesit, është gjetur se i njëjti nuk përmbushë as kërkesa tjera sipas DT të cilat nuk janë cekur fare në njoftimin mbi vendimin. Si shembull, nuk është dorëzuar licenca nga oda e inxhinierëve për gjeodetin ndërsa në DT është kërkuar shprehimisht gjeodeti me licensë nga oda e inxhinierëve. Tutje, nuk është vulosur CV e menaxherit sikurse kërkohet me DT. Nuk janë prezantuar CV për 13 punonjësit fizik. Mungon vendimi për menaxher, etj.

Sa i përket pretendimeve kundër tenderuesit të rekomanduar se i njëjti nuk ka prezantuar min. 13 punonjës fizik, vlen të ceket se të dy OE në grupin e OE së bashku kanë prezantuar mbi 20 punonjës fizik duke e tejkaluar dukshëm kërkesën e DT.


Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 04.11.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.


Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net